

AUTOKTONIA, LASHTËSIA DHE IDENTITETI SHQIPTAR NË KOSTUMIN TRADICIONAL TË MIRDITËS

Dr.Nikollë LOKA, Dod LULI
Akademia “Rrënjët Tona”

PËRMBLEDHJE

Ata që studiojnë kulturën materiale e kuptojnë se veshja është objekti më intim, që pasqyron të dhëna për njerëzit që e kanë veshur. Banorët e territoreve që më vonë u quajtën Mirditë, për shkak të terrenit të thepisur malor dhe rrugëve të ngushta, gjatë pesë shekujve të sundimit osman, u mbyllën në vetvete, por ruajtën të paprekura tiparet e tyre. Rendi shoqëror fisnor kishte vazhduar të jetonte gjatë gjithë kohës nëpër male dhe vetëm u forcua pas ardhjes së turqve. Në veshjet e Mirditës lexohet hershmëria dhe origjina. Elementet më të vjetër të kostumit mirditor janë këmisha e gjatë, si për burra dhe për gra, si dhe dollama, që ishte si një pallto e hapur, me mëngë dekorative që varen. Këmisha dekorohet në mënyrë elegante dhe interesante, me një fill të hollë dhe shkëlqyes, që dallohet për finesë dhe tregon fisnikëri. Kostumi mirditor i burrave dallon pak nga ai i trevave përreth, ndërsa ai i grave ka disa dallime dhe shpreh origjinalitet, hershmëri dhe autoktoni. Në dekorin e xhupes ose llahengës lexohet krishtërimi i hershëm, i stilizuar me lloj - lloj formash, ndonjëherë të fshehta dhe ndonjëherë të hapura. Elemente të tjera dalluese që e bëjnë të veçantë gruan mirditore është frizura e grave, mënyra e krehjes së flokëve dhe si ato e lidhin shaminë, me të cilat tregojnë moshën dhe statusin e tyre, traditë vjen që nga periudha ilire.

Fjalë kyçe: Mirdita, kostum popullor, veshje e burrit, veshje e gruas.

ABSTRACT

Those who study material culture understand that clothing is the most intimate object, reflecting information about the people who wore it. The inhabitants of the territories that were later called Mirditë, due to the steep mountain terrain and narrow roads, during the five centuries of Ottoman rule were closed to themselves, keeping intact their features. The kinship social order had continued to live all the time in the mountains and only strengthened after the arrival of the Turks. In Mirdita's traditional costumes read antiquity and origin. The oldest elements of the Mirditor costume are the long shirt, for both men and women, as well as the dollamas, which was like an open coat with decorative hanging sleeves. The shirt is decorated elegantly and interestingly, with a thin and shiny thread, which is distinguished by finesse and shows nobility. The Mirditor costume of men differs slightly from that of the surrounding areas, while that of women has some differences and expresses originality, antiquity and autochthony. In the decor of the sweatshirt or sweatshirt read early Christianity, stylized with all sorts of shapes, sometimes hidden and sometimes open. Other distinctive elements that make Mirdita woman special are the women's hairstyle, the way of combing their hair and how they tie the scarf, with which they show their age and status, the tradition comes from the Illyrian period.

Key word: Mirdita, folk costume, men's clothing, women's clothing.

HYRJE

Veshja është një komponent i rëndësishëm i jetës së përditshme, pasi nëpërmjet tyre individët krijojnë ndjenjën e tyre për veten, si dhe vendin e tyre në shoqëri. Lidhjet midis veshjes dhe identiteteve individuale dhe kolektive vazhdojnë të studiohen me interes nga studiuesit. Veshjet popullore kombëtare

janë formuar dhe përdorur në rrethana të caktuara gjeografike e shoqërore, duke evoluuar vazhdimisht brenda traditave të ndryshme. Ndonëse territori ku banojnë shqiptarët është relativisht i vogël, ata kanë një numër të madh kostumesh popullore dhe kjo ka shpjegimin e vet. Që nga periudha e principatave feudale arbëre, territoret shqiptare nuk kanë qenë të unifikuara në një njësi shtetërore; trevat e ndryshme kanë komunikuar me vështirësi njëra me tjetrën për shkak të pengesave gjeografike: male të larta, lumenj etj. Nga ana tjetër, në territoret shqiptare, të ndara në njësi të ndryshme administrative, nganjëherë të ndarë dhe në mes të pushtesve të ndryshëm, nuk pati asnjëherë një treg unik dhe prodhimet e zejtarisë nuk depërtuan në të njëjtën kohë në të gjithë vendin. Veshjet popullore sot paraqesin një larmi të madhe, megjithatë gjejmë edhe disa elemente të përbashkëta. Elementet krahinore të veshjeve na japin të kuptojmë se deri në ç'masë ruhej izolimi krahinor, kurse prania e tipareve të përbashkëta për disa zona tregon se në ç'shikullë ishte realizuar afrimi ndërkrahinor dhe kombëtar në këtë fushë.¹ Te kostumet tradicionale të krahinave të ndryshme shqiptare ka ngjashmëri, e cila flet për një trashëgimi të përbashkët në veshje që nga periudha ilire e në vijim. Burrat ilirë mbanin fustanellë deri tek gjuri, që u ruajt për mijëra vjet dhe mbeti qendrore në veshjen popullore bashkëkohore shqiptare. Ndër përbërësit e tjerë të kostumit ilir ishin mantelet e leshit dhe shumë elemente të kostumeve tradicionale të meshkujve që mbahen ende sot nga fshatarët e vendbanimeve rurale, si kësulat e pangjyrosura dhe opingat.² Veshjet popullore të Mirditës kanë edhe disa veçori karakteristike, që i dallon nga veshjet e trevave përreth. Ato vijjnë pothuajse pa ndikime bizantine, sllave dhe osmane, tregues i jetesës së lirë në male. Mirdita është një krahinë që ka ruajtur mirë elementet e kulturës materiale dhe shpirtërore, prandaj është me interes studimi i elementeve autoktonë ilirë dhe arbër në veshjen tradicionale të saj.

NJË VËSHTRIM MBI VESHJET POPULLORE SHQIPTARE

Veshjet popullore shqiptare janë përpunuar nga tradita në përshtatje me veçoritë e jetës e të historisë së bashkësisë etnike shqiptare. Ato kanë variante që ndryshojnë sipas moshës, seksit, krahinës, kushteve të punës, jetesës, zakoneve e festave. Në to pasqyrohen veçantitë e kulturës dhe të shijeve artistike të popullit tonë, të ruajtura me vazhdimësi në epokat e mëvonshme historike, sidomos në mjediset fshatare. Veshjet popullore janë rezultat i një procesi të gjatë ndryshimi të ndikuar nga disa faktorë: historikë, ekonomikë, socio-kulturorë. Nga roli i tyre i dobishëm dhe funksioni që kryejnë, veshjet përbëjnë një nga elementet më të rëndësishëm të kulturës materiale dhe shpirtërore, Struktura morfologjike e tyre, karakteri i veçantë i elementeve të zbukurimit etj. përcaktojnë specifikën kombëtare të popullit tonë.³ Për veshjet tona popullore flitet pas formimit të kombësisë shqiptare. Siç dihet formimi i bashkësive ekonomike e kulturore te shqiptarët filloi në shek. XII me Principatën e Arbërit dhe vazhdoi pastaj me principatat e tjera feudale shqiptare, kur nisën të marrin pamjen e tyre edhe veshjet popullore të veçanta e në këtë kontekst, u krijua ajo larmi e pasurisë së kostumeve popullore, gjurmët e të cilave u ruajtën deri më sot. Pothuajse çdo rajon kulturor dhe gjeografik në Shqipëri ka variantin e tij specifik të kostumeve që ndryshojnë në detaje, materiale, ngjyrë, formë etj.

¹ Andromaqi Gjergji, Veshjet shqiptare në shekuj-Origjina, topologjia, zhvillimi, Tiranë 1988, f.8.

² Leyla Belkaïd, "Albania", Encyclopedia of National Dress, Traditional Clothing around the World, Volume 1, Editor Jill Condra, ABC-CLIO, LLC, 2013, p.12.

³ Andromaqi Gjergji, Veshjet shqiptare në shekuj-Origjina, f.7.

Në veshjet për burra, tipi më i përhapur deri në fund të shek.XIX ka qenë veshja me fustanellë dhe veshja me tirq e cila, që në dhjetëvjeçarët e fundit të shekullit të kaluar, fillon të shtrihet edhe në zona ku nuk mbahej më parë, duke zbritur gjithnjë drejt jugut. E përhapur ishte dhe veshja me brekushe, e cila shtrihej kryesisht në Shqipërinë e Mesme. Deri nga fillimi i shek.XX në disa zona të vendit përdorej tipi i veshjes me këmishë të gjatë e dollamë.⁴

Fig. – I Veshje popullore të Mirditës



Në veshjet për gra, më i përhapuri ishte tipi me këmishë të gjatë e një përparje (që plotësohej me një xhokë leshi për stinën e ftohtë) dhe që shfaqet me variante të shumta e të pasura zonale. Interes të veçantë për origjinalitetin e saj të theksuar paraqet

veshja me xhubletë. Tip tjetër ishte veshja me këmishë të gjatë e dy futa (njëra përpara, tjetra prapa) dhe ajo me mbështjellëse.⁵ Identiteti dhe veshja janë të lidhura ngushtë. Rrobat shfaqin, shprehin dhe formësojnë identitetin, duke e mbushur atë me një realitet drejtpërdrejt material. Duke pasqyruar veçori lokale, veshja në komunitetet lokale historikisht ka mbartur forma shumë specifike, të ngulitura thellë në traditën dhe praktikën sociokulturore lokale.⁶ Pjesët e veshjes për masat e gjëra fshatare në këta shekuj punoheshin kryesisht brenda kuadrit të ekonomisë shtëpiake, me lëndë që nxirrej nga prodhimet bujqësore e blegtorale, siç ishin lëkura, leshi, liri, kërpi e mëndafshi. Pëlhura më e vjetër prej kërpi, e ruajtur deri më sot në vendin tonë, është e vitit 1373, por dihet mirë se pëlhura prej liri e kërpi kanë vijuar të përdoren gjërësisht në veshjet popullore, deri në fillim të shekullit XX, e në disa krahina edhe më vonë.⁷ Me sjelljen nga jashtë të pëlhurave të pambukta, lirin nuk e mbillnin më dhe nuk përdorej për veshje, veç iu ruajt emri.⁸ Mëndafshi vazhdoi të përdoret. Pëlhurat e mëndafshita punoheshin në vegë horizontale, në dy lisa ashtu si dhe gjithë pëlhurat e tjera të holla prej liri, gjineshtre, kërpi, pambuku etj. Para shekullit të 20-të, tekstilet shqiptare lyheshin me substanca bimore për të prodhuar disa nuanca të ngjyrës së zezë, vjollcë, kafe, të kuqe të errët, blu të errët, jeshile dhe të verdhë.⁹

Lashësia, autoktonia dhe identiteti shqiptar në veshjet tradicionale të Mirditës

⁴ Veshjet popullore shqiptare, <https://wiki.shqipopedia.org/veshjet-popullore-shqiptare>

⁵ Veshjet popullore shqiptare, <https://wiki.shqipopedia.org/veshjet-popullore-shqiptare>

⁶ Clothing As A Powerful Container Of National And Community Identity, <https://science.jrank.org/pages/9029/Dress-Clothing-Powerful-Container-National-Community-Identity.html>

⁷ Çfarë tekstilësh përdoren në veshjet shqiptare të mesjetës, <https://www.kultplus.com/trashegimia/cfare-tekstileshe-perdoreshin-ne-veshjet-shqiptare-te-mesjetes/>

⁸ Pal Doçi, Mirdita vatër e qëndresës antiosmane, botimet "Mirdita", Tiranë 1999, f.35.

⁹ Leyla Belkaïd, "Albania", Encyclopedia of National Dress, Traditional Clothing around the World, Volume 1, Editor Jill Condra, ABC-CLIO, LLC, 2013, p.14.

Kultura shqiptare në shekuj është përbërë prej dy sferave themelore: Kultura rurale, që ishte dominante, nga fakti se 90 përqind e popullësisë banojnë në fshat¹⁰ dhe kultura urbane e qyteteve, që përfshinte vetëm 10 përqind të popullësisë. Kultura rurale ishte më e paprekur nga ndikimet e huaja dhe ajo u ruajt në përgjithësi në fshatra, si në Mirditë, ku nuk u vendosën pushtimet e huaja dhe sot ruan gjurmët e kulturës së hershme shqiptare edhe në veshje.¹¹ Për shumë kohë, pushtuesi osman i kishte bllokuar tregjet e qyteteve për, mirditorët dhe ata kanë qenë të detyruar të gjejnë tregje alternative në trevat fqinje jashtë qyteteve, kryesisht për të blerë drithin, ndërsa blerja e veshjeve që shiteshin në tregjet e mëdha të qyteteve për shumë kohë qenë të bllokuara. Mirditasit i kanë prodhuar vetë veshjet, brenda ekonomisë shtëpiake, sipas modeleve tradicionale të trashëguara brez pas brezi. Pak a shumë, në të njëjtat pozita janë gjendur dhe trevat malore fqinje. Në ato rrethana, kanë lulëzuar veçoritë lokale të trevave dhe janë ruajtur elemente veshje me origjinë të lashtë.¹²

Veshjet prej leshi dhe leshi të përpunuar (shajaku) në kostumin mirditor vijnë në një formë të thjeshtë deri në shekullin e njëzetë. Të gjitha rrobat, që më vonë u prodhuan prej liri dhe këрпи, fillimisht ishin prej leshi, përfshirë këmishat, brekët, xhamadanët etj. Shajakun në dy apo katër liq dinin ta bënin pothuajse të gjitha gratë. Shajaku i bërë në katër liq, shkilej në valanecë, pritej e qepej për burra dhe për gra, ndërsa ai në dy liq përdorej kryesisht në shpërgej e rroba për gra e fëmijë. Në masë më të paktë përdoreshin rrobat prej liri, më shumë për veshjet e brendëshme, të cilat edhe pasi u zëvendësuan prej pambuku vazhduan të quhen “të linta”, madje dhe në ditët e sotme, brekëve u thonin “tlina”.¹³ Përdorimi i pëlhurave të pambukut në Mirditë është më i ri dhe daton në fund të shekullit të nëntëmbëdhjetë.¹⁴

Fig.- 2 Kostumi i burrit mirditor



Veshjet mirditore janë me elemente të pastra shqiptare, pa ndikime osmane dhe sllave. Kostumi i burrave të Mirditës ndryshon pak nga ai i trevave fqinje. Veshja e vjetër ishte ajo me brekesha e këmishën përmbi to dhe pastaj dollamën prej shajaku të bardhë, të qepur e të zbukuar hijshëm me gajtana të



¹⁰ Stefanaq Pollo, La culture populaire expression des particularites nation albanaise, La Conference Nationale des Etudes Ethnograph d’Albanie, Tirana 1977, p.56.

¹¹ Pal Doçi, Mirdita, vatër e qëndresës antiosmane, f.245.

¹² Andromaqi Gjergji, Veshjet shqiptare në shekuj, f.105.

¹³ Pal Doçi, Mirdita vatër e qëndresës antiosmane, f.35.

¹⁴ Pal Doçi, Mirdita vatër e qëndresës antiosmane, f.35.

zi, kostum ky që me pak dallime mbahej edhe në Mat e Dibër.¹⁵ Nën ndikimin e trevave fqinje, mirditasit përdorën edhe xhamadanin e leshtë me mëngë ose pa mëngë; xhurdinë e zi me jakë dhe tufa në fund; tirqit prej shajaku të bardhë me gajtana të zi; brezin e leshtë me ngjyrë të kuqe etj. E vjetër në Mirditë konsiderohet veshja me këmishë dhe brekesha, që ishte prej liri ose prej leshi të shkelur ose jo. Brekeshat vijnë që nga Mesjeta dhe përmenden së pari në një dokument të vitit 1330.¹⁶ Ato ishin veshje para turke me origjinë të vjetër dhe nuk duhen ngatërruar me shallavaret orientale që mbanin burrat katolikë shkodranë deri në shpalljen e Pavarësisë.¹⁷ Marin Bici i përmend brekeshat si veshje të mirditorëve gjatë vizitës së tij atje në vitin 1610. Nga elementet e veshjeve të vjetra të burrave, akoma mbahen edhe sot kësulatat e bardha dhe opingat (këpucët prej lëkure primitive).¹⁸

Fig. - 3 Kostumi mirditor(nusja dhe dhëndrri)



Shkenca antropologjike i konsideron të lashta këmishat e gjata e të shkurtëra, për burra e për gra, që në kulturën ilire njihet me emrin dalmatika ilire, ose pjesët kostumore që zbukurohen me thekë e me tufa, siç është rasti me përparset e grave etj.¹⁹ Veshja popullore e grave të Mirditës i përket një tipi veshje për gra, shumë të përhapur në vendin tonë dhe në vise të tjera të Ballkanit, si veshje me këmishë të gjatë dhe përparse. Pjesë kryesore e kësaj veshje është këmisha e gjatë, me mëngë të gjata, të gjëra ose të ngushta. Në mes ajo shtërngohej nga një brez leshi me ngjyra të ndryshme dhe shoqërohej në pjesën e përparme nga një përparse e leshtë ose e pambuktë, me madhësi e zbukurime që ndryshonin nga njëra krahinë në tjetrën. Në stinën e verës, në pjesën e sipërme, gruaja e veshur me këtë këmishë mbante një jelek, kurse në dimër sipër tij shtonte edhe një xhokë prej shajaku.

Fig. - 3 Veshja e nuses mirditore

Gjatësia, ngjyra dhe zbukurimi i xhokës ndryshonte nga njëra krahinë në tjetrën, duke krijuar kështu veçori të shumta lokale. Kjo veshje që e përhapur në Mirdite, Dibër, Mat, Shpat, Çermenikë, Dumre, Myzeqe, Berat, Korçë, Kolonjë, Gjirokastër, Sarandë, etj.

Elementet kryesore të kostumit të gruas mirditore janë: këmisha e gjatë deri te puplat e këmbës, një xhokë ose xhupe shajaku (me ose pa mëngë) që vishet mbi të, pastaj brezi dhe përparsjja dhe së fundi mbulesa e kokës dhe opingat.²⁰

¹⁵ Andromaqi Gjergji, "Mirdita ishte një trevë e begatë për kërkin botimet "Mirdita" Tiranë 2002, f.11.


¹⁶ Afërdita Onuzi, Veshjet shqiptare në shekujt XIV-XV, reflektim numër 1, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i studimit të arti

¹⁷ Andromaqi Gjergji, Veshjet shqiptare në shekuj, f.129.

¹⁸ Leyla Belkaïd, "Albania", Encyclopedia of National Dress. Volun

¹⁹ Veshjet popullore thesar i trashëgimisë kulturore, <https://teleg.trashegimise-kulturore/>

²⁰ Andromaqi Gjergji, "Mirdita ishte një trevë e begatë në Mirdita



Vëmendje tërheq kostumi i nusërisë, që përbëhet nga kësula me strenglat, antaria, këmisha, fundi, tlinat, çorapet dhe këpucët etj. Për nusët, stolitë metalike përdoren dhe, me sa duket, kishte rendësi jo vetëm funksioni i tyre estetik, por edhe funksioni magjik i tyre. Rëndësi të veçantë i kushtojë zbulimit të kokës. Por, disa vjet pas martesës, veshja e gruas fillonte të lehtësohej nga zbulimet. Vajza mirditore vishej thjeshtë. Ngjyra mbizotëruese e veshjes së saj ishte e bardha dhe e zeza, pra kishte një kufizim ngjyrash. Kjo dukuri ka ekzistuar deri vonë, pasi sipas mentalitetit të njerëzve “vajza nuk duhet të zbulohet para se të martohet”. Të drejtë për zbulim ajo kishte vetëm ditën e martesës së saj, kur shkonte te burri. Madje, dhe krehja duhet të ishte sa më e thjeshtë, që vajza mos të nxirrte në pah bukurinë dhe shamia e saj duhet të ishte sa më poshtë ballit.²¹ Kostumi mirditor për burra dhe gra përdor pak ngjyra, por të kombinuara hijshëm ku mbizotëron e bardha, e kuqja dhe e zeza. Para shekullit të 20-të, tekstilet shqiptare lyheshin me substanca bimore për të ngjyrosur rrobat. Burrat preferonin të vishnin pëlhurë leshi të pangjyrosur me nuanca kremi të bardhë.²²

Fig. – 4 Kostum i gruas mirditore

Një kostum popullor (rajonale, apo kombëtar) shpreh një identitet që zakonisht lidhet me një zonë gjeografike ose një periudhë kohore në histori. Veshjet popullore janë trashëgueset dhe transmetueset e elementeve që vijnë nga Lashtësia dhe nga Mesjeta.²³ Veshja mirditore është zbuluar me elemente antike ilire dhe mesjetare arbëre. Në veshjet popullore të Mirditës, një sy i stërvitur mund të dallojë jo vetëm elemente mesjetare, por edhe elemente që vijnë nga koha e vjetër. Ka edhe gjurmë që duket se lidhen me pjesë veshjesh të dokumentuara që në prehistori.

Një ndër to është përparsja me thekë e kostumit të grave, që paraqet ngjashmëri të dukshme me përparsen e veshjes së gruas të figurinës neolitike të gjetur në Kličevaç (Jugosllavi), që i përket mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, duke u lidhur me kulturat e lashta parailire dhe ilire. Në mbështetje të këtij mendimi vijnë dy fakte: së pari, në gjenezën e veshjeve, përparsja dhe brezi konsiderohen si elementet më të lashtë. Edhe brezi me tufat e veshjes së grave mirditore lidhet gjenetiki me të njëjtën figurinë neolitike, si dhe përparsja me thekë.²⁴ Xhoka (xhaketa e zbuluar me thekë të trashë leshi të ngjyrosur në të kuq), ndoshta daton që nga koha ilire.²⁵ Thuhet se shamia e zezë e grave të Mirditës është mbajtur në shenjë zie pas vdekjes së Skënderbeut,²⁶ Për t’u dalluar është dhe dekori i xhupit.

²¹ Intervistë me etnografin Afërdita Onuzi, <http://w.zemrashqiptare.net/neës/36899/rp-0/act-print/rf-1/printo.html>

²² Leyla Belkaïd, “Albania”, Encyclopedia of National Dress,... Volume 1, p.14.

²³ Ledio Xhorxhi, Vazhdimësia iliro-shqiptare në veshje, <https://xhoxhi.files.wordpress.com/2018/06/vijimc3absia-e-kulturc3abs-iliro-shqiptare-nc3ab-veshje.pdf>;

²⁴ Andromaqi Gjergji, “Mirdita ishte një trevë e begatë “ në Mirdita, intervista II, botimet “Mirdita“ Tiranë 2002, f.12; Mark Tirta, Etnologjia e shqiptarëve, Geer, Tiranë 2006, f.441.

²⁵ Leyla Belkaïd, “Albania”, Encyclopedia of National Dress. Volume 1, p.12.

²⁶ Afërdita Onuzi, Veshjet shqiptare në shekujt... Antropologji, vëllimi 2, numër 1, f. 43-44.

Veshja mirditore, sidomos ajo e grave, përmban elemente të ndryshme simbolike. Pavarësisht mbishtresëzimeve, xhupi i gruas mirditore ruan një larmi simbolikash mitike dhe kultike (pema e jetës, simboli i diellit, rrathë koncentrikë, lotusi mistik etj), çka tregon për hershmërinë e saj, si gjurmë e rëndësishme e kultures iliro-arbërore.²⁷ Rëndësi në veshjen mirditore kanë dhe zbukurimet, disa prej të cilave ishin përdorur që në Mesjetë.

Fig. - 5 Veshje të femrave mirditore të moshave të ndryshme.



Vathët prej argjendi të grave të Mirditës ngjajnë me gjetjet arkeologjike të Komanit, Buklit dhe Krujës të shekujve VI-VIII.²⁸ Në vitin 1919, Artur Haberlandi

ka publikuar një paftë brezi prej tunxhi të gjetur në Mirditë, forma dhe zbukurimet e së cilës të shtyjnë të mendosh për lidhje eventuale të saj me kulturën ilire.²⁹ Elemente të tjera dalluese që e bëjnë të veçantë gruan mirditore është frizura e saj, ku mënyra e rregullimit të flokëve tregon moshë dhe status, imitim i perëndeshave ilire.³⁰

Në vise të ndryshme fshatare të bërit e veshjeve, qëndisjet, dantellat, thurjet trashëgoheshin nga brezi në brez: Gratë e vjetra e më të ditura në këto mjeshteri mësonin vajzat e gratë e reja, që jo vetëm të bënin gjëra të tilla, por që ato t'i bënin me art, t'i stolisnin veshjet me shije, ngjyra e motive të ndryshme, sipas kërkesave e estetikës krahinore e kombëtare.

Një nga vlerësimet më themelore për gruan në bashkësitë patriarkore ishte të dijë të bëjë punëdore të mira dhe rroba të bukura. Në qytetet e ndryshe kishte rrobaqepës burra profesionistë që punonin me pagesë zeje shtëpiake. Të interesuarit çonin materialin dhe rrobaqepësi qepte veshjen kundrejt pagesës. Po ashtu veprohej dhe për rrobaqepësit a qëndistarët që punonin në fshatra me pagesë.³¹ Mirditorët i kanë qepur rrobat e tyre kryesisht brenda krahinës, ku si familje e njohur për prerjen dhe qepjen e rrobave popullore ka qenë ajo me mbiemrin Bardhi në Simon.³²

Zhvillimi i zejtarisë së veshjeve çoi në modernizimin e veshjeve, duke ruajtur elementët karakteristikë të tyre. Nganjëherë në vend të shajakut, ashtu si e bënte fshati, rrobaqepësit fusnin në përdorim cohën e bërë në fabrika, fijet e qepjes e gajtanat e importi nisën të përdorin më shumë ngjyrën e kuqe te kostumi i grave

²⁷ Leyla Belkaïd, "Albania", Encyclopedia of National Dress. Volume 1, p.12.

²⁸ Andromaqi Gjergji, Veshjet shqiptare në shekuj, f.241.

²⁹ Andromaqi Gjergji, "Mirdita ishte një trevë e begatë, në Mirdita, intervista II, f.12.

³⁰ Afërdita Onuzi, Frizura mbretërore e mirditoreve, <https://alb-spirit.com/2017/05/14/frizura-mbreterore-e-mirditoreve/?fbclid=IwAR19hAHhKx7Z4qVzI2IfiWHvEhIUxFIOPVdMkWCnPDWKb5PW--XeV7Dbj4>

³¹ Mark Tirta, Etnologjia e shqiptarëve, Geer, Tiranë 2006, f.500-501.

³² Pal Doçi, Mirdita vatër e qëndresës antiosmane, f.35.

xhamadanat e bardhë a kafe të kostumit të burrave, përvese të bardhë, i bënë të kuq, krejt jashtë natyrës së traditës. Këta xhamadana të kuq u blenë nga krerë apo burr të familjeve të pasura, të cilët dëshironin të dalloheshin nga të tjerët në veshje. Zhvillimi i zejtarisë së veshjeve dhe lindja e profesionit të rrobaqepësit profesionist në Mirditë ndikoi në pasurimin e kostumeve mirditore të grave dhe të burrave me elemente të reja, duke i bërë me të bukur, pavarësisht se ato kostume, sidomos i grave, e ruajti në tërësi origjinalitetin e tij dhe elementet e vjetra antikë e mesjetare që trashëgoi, duke përcjellë ndër breza autoktoni dhe identitet.

PËRFUNDIME

1. Mirditasit, banorë të një krahine të ashpër malore të izoluar për shkak të kushteve gjeografike dhe rrethanave historike, i kanë prodhuar vetë veshjet dhe komunikimin me tregjet i kanë pasur më të rrala se trevat e tjera.
2. Në ato rrethana, kanë lulëzuar veçoritë lokale dhe janë ruajtur elemente veshje me origjinë të lashtë.
3. Ka një ngjashmëri, e cila flet për një trashëgimi të përbashkët veshjet e mirditës me disa treva fqinje, kryesisht të Kurbinit, Matit dhe të Dibrës. Veshja e vjetër e burrave kishte një këmishë të gjatë dhe brekesha, si në shumë treva veriore, me njëfarë ngjashmërie me fustanellën e përdorur në jug.
4. Veshja me tiq e burrave ngjan me trevat fqinje, kryesisht me Dibrën.
5. Veshja popullore e grave të Mirditës i përket një tipi veshje për gra, shumë të përhapur në vendin tonë, si veshje me këmishë të gjatë dhe përparse, që haset në shumë krahina të vendit.
6. Veshja e grave mirditore paraqet interes në disa elemente të saj, që tregojnë lashtësi, ku një sy i stërvitur mund të dallojë jo vetëm elemente mesjetare por edhe elemente që vijnë nga koha e vjetër.
7. Përparsja me thekë e kostumit të grave dhe brezi me tufa paraqesin ngjashmëri me përparsen e veshjes së gruas të figurinës neolitike të gjetur në Kličevaç (Jugosllavi), që i përket mijëvjeçarit të dytë para erës sonë, duke u lidhur me kulturat e lashta parailire dhe ilire.
8. Vathët prej argjendi të grave të Mirditës ngjajnë me gjetjet arkeologjike të Komanit, Buklit dhe Krujës të shekujve VI-VIII.
9. Mënyra e veçantë e rregullimit të flokëve të gratë dhe kësula e strenglat të veshja e nuses mirditore paraqesin moshë dhe status, imitim i veshjeve të lashta ilire.

STUDIME MBËSHTETËSE DHE REFERENCA

1. Belkaïd, Leyla. "Albania", Encyclopedia of National Dress, Traditional Clothing around the World, Volume 1, Editor Jill Condra, ABC-CLIO, LLC, 2013.
2. Clothing As A Powerful Container Of National And Community Identity, <https://science.jrank.org/pages/9029/Dress-Clothing-Poëerful-Container-National-Community-Identity.html>
3. Çfarë tekstilësh përdorëshin në veshjet shqiptare të mesjetës, <https://www.kultplus.com/trashegimia/cfare-tekstileshe-perdoreshin-ne-veshjet-shqiptare-te-mesjetes/>
4. Doçi, Pal. Mirdita vatër e qëndresës antiosmane, botimet "Mirdita", Tiranë 1999.
5. Gjergji, Andromaqi. Veshjet shqiptare në shekuj-Origjina, topologjia, zhvillimi, Tiranë 1988.

6. Intervistë me etnografen Afërdita Onuzi, <http://w.zemrashqiptare.net/neës/36899/rp-0/act-print/rf-1/printo.html>
7. Onuzi, Afërdita Veshjet shqiptare në shekujt XIV-XV, reflektim etnografik, Antropologji, vëllimi 2, numër 1, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe i studimit të artit, Tiranë 2019.
8. Onuzi, Afërdita. Frizura mbretërore e mirditoreve, <https://alb-spirit.com/2017/05/14/frizura-mbreterore-e-mirditoreve/?fbclid=IëAR19hAHhKx7Z4qVzI2IfiEHvEhIUIxFIOPVdMkËCnPDËKb5PË--XeV7Dbj4>
9. Pollo, Stefanaq. La culture populaire expression des particularites ethniques et la formation de la nation albanaise, La Conference Nationale des Etudes Ethnographiques, Academie des Sciences de la RPS d'Albanie, Tirana 1977.
10. Tirta, Mark. Etnologjia e shqiptarëve, Geer, Tiranë 2006.
11. Veshjet popullore shqiptare, <https://wiki.shqipopedia.org/veshjet-popullore-shqiptare>
12. Veshjet popullore thesar i trashëgimisë kulturore, <https://telegrafi.com/veshjet-popullore-thesar-i-trashegimise-kulturore/>
13. Xhorxhi, Ledio Vazhdimësia iliro-shqiptare në veshje, <https://xhoxhi.files.wordpress.com/2018/06/vijimc3absia-e-kulturc3abs-iliro-shqiptare-nc3ab-veshje.pdf>;